



04-09-15

KËRKESË PADI

drejtuar **GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË -TIRANË**

PADITËS: Instituti Shqiptar i Shkencave, organizatë jofitimprurëse e krijuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3048, datë 28.03.2011 e përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive znj. Aranita Brahaj, me adresë: Rruga "Asim Vokshi", Pallati 13/25, Kati 3, Tiranë dhe me numër telefoni 068 20 01 718.

TE PADITUR: 1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa 80, Hyrja 1, Tiranë.

2. Partia Socialiste e Shqipërisë me adresë: Sheshi Austria, nr. 91, Tiranë.

3. Partia Demokratike e Shqipërisë me adresë: Bulevardi Zhan D'Ark, nr. 11, Tiranë.

4. Lëvizja Socialiste për Integrim me adresë: Rruga "Sami Frashëri", Godina 20/10, Tiranë.

OBJEKTI: - Shfuqizimi i vendimit nr. 44, datë 22.07.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Detyrimin e partive politike (subjekteve zgjedhore) Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim t'i japë Institutit Shqiptar të Shkencave informacionin e kërkuar për financimin e fushatës zgjedhore, të kërkuar prej këtij të fundit në datën 09.06.2014.

BAZA LIGJORE: Neni 9, paragrafi i tretë i Kushtetutës, neni 2 shkronja "c", neni 3 dhe neni 25 i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe neni 11, neni 15 shkronja "d", neni 16, neni 17, shkronja "a" dhe "ç" dhe neni 18 i ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

I nderuar zoti/zonja Gjyqtar/e.

Instituti Shqiptar i Shkencave është një organizatë jofitimprurëse e krijuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3048, datë 28.03.2011. Objekti i veprimtarisë së kësaj organizate, sipas Statutit të saj, është :

- Bashkëpunimi me organe dhe ente mediatike për të bërë pasqyrimin dhe vlerësim të temave të rëndësishme për grupe sociale dhe grupe interesi me rëndësi në problematikën dhe zhvillimin e shoqërisë civile.
- Promovim dhe inicim i informacioneve dhe iniciativave ligjore apo qytetare me qëllim njohjen , garantimin dhe respektimin e të drejtave të individëve dhe grupeve sociale.
- Sensibilizim mbi tema që lidhen me çështje të sigurisë, qeverisjes dhe bashkëjetesës sipas parimeve dhe kriterëve të vendosura nga legjislati kombëtarë e legjislati evropian

Në datën 09.06.2014 Instituti Shqiptar i Shkencave i dërgoi tre subjekteve zgjedhore kryesore në vend, përkatësisht Partisë Socialiste (PS), Partisë Demokratike (PD) dhe

Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI) kërkesën zyrtare me shkrim në të cilën kërkonte prej secilit prej këtyre subjekteve informacion për:

- a) listën e dhuruesve të fondeve jopublike që keni përfituar prej datës 21 maj 2015 dhe që janë mbi shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë ose shërbime apo sende të barasvlershme me të;
- b) listën e çdo shpenzimi që keni kryer eventualisht prej datës 21 maj 2015 me fondet vjetore të përfituara nga buxhetit i shtetit 2015.

Subjektet zgjedhore të sipërcituara e kanë marrë kërkesën në datën 10 - 11.06.2015 dhe kjo vërtetohet me dëftesat postare të marrjes së kërkesës.

Subjektet zgjedhore të mësipërme nuk iu përgjigjën kësaj kërkesë, ndaj në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" Instituti Shqiptar i Shkencave paraqiti kërkesë ankimore pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në datën 7.07.2015.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në datën 25.07. 2015 na vuri në dijeni për vendimin e tij nr. 44, datë 22.07.2015 "Për rrëzimin e ankesës", me anë të të cilit rrëzonte kërkesën ankimore të paraqitur prej nesh me nr. 675 prot., datë 9.07.2015 me arsyetimin se "*informacioni administrohet nga organizata të cilat në kuptim të këtij ligji dhe konform nenit 2 të tij, për nga mënyra e organizimit të tyre, funksionimit dhe kuadrit ligjor rregullator nuk përkufizohen si autoritete publike*".

Në mbështje të nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" paraqitet kjo kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Instituti Shqiptar i Shkencave, sipas nenit 15, shkronja "d" të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ka legjitimitet sepse është organizatë jofitimprurëse e krijuar me vendimin gjyqësor sipas legjislacionit në fuqi, në objektin e veprimtarisë së tij përfshihet edhe transparencja e financimit të fushatës zgjedhore dhe në përgjithësi çështje të së drejtës për informim, si dhe transparencja e financimit të fushatave zgjedhore përbën një interes të ligjshëm publik, të përcaktuar si të tillë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjet në fuqi dhe dokumentat ligjorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Kërkesëpadija jonë bazohet në nenin 9, paragrafi i tretë i Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 2, shkronja "c" dhe neni 3 i tij.

E drejta kushtetuese për informim është e lidhur ngushtë me konceptin e transparencës. Transparencja, në kohë reale, e financimit të subjekteve zgjedhore në fushatë zgjedhore përbën një parakusht themelor kushtetues, të cilin subjektet zgjedhore janë të detyruar ta respektojnë. Respektimi i saj buron si detyrim prej parimit kushtetues se shtetasit duhet të jenë të informuar, edhe për këtë aspekt financimi, përpara se të hedhin votën e tyre në ditën e votimit.

Kërkesa jonë përqëndrohet në aksesin në informacion. Ekzistenca e këtij informacioni (që njëkohësisht është objekti i kërkesës drejtuar subjekteve zgjedhore), në një fazë të mëvonshme kohore kur subjektet zgjedhore të kenë bërë raportimet përkatëse pranë KQZ-së, nuk garanton ushtrimin e plotë dhe efektiv të së drejtës për të kërkuar dhe marrë informacion. Aksesin në informim buron prej marrdhënies që krijohet mes së drejtës së shtetasve për të kërkuar informacion dhe detyrimit që ata që e kanë këtë informacion ta japin ose publikojnë atë pa vonesë dhe në kohën e duhur për të mundësuar për të parët vendimmarrjen në votim. E drejta e informimit,

në kohë reale gjatë fushatës zgjedhore, i ka rrënjët në natyrën publike të informacionit dhe nëse ky informacion është në duart e një partie politike apo në duart e institucioneve publike apo private kjo ka rëndësi dytësore.

Në të kundërt me atë që paraqitet në vendimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, partitë politike – subjektet zgjedhore ne zgjedhje - në mbështetje të nenit 2, shkronja “c” të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” janë autoritete publike sepse:

i) *Partitë politike financohen në pjesën më thelbësore të tyre prej buxhetit të shtetit dhe se përfitojnë donacione jopublike për të arritur qëllime të rëndësishme publike.* Forma më e zbatuar është ajo e financimit të drejtëpërdrejtë prej tij. Financimi thelbësor në këtë kuptim, nuk duhet të shihet ngushtë vetëm në raportin sasior publik/jopublik të të ardhurave që subjekti zgjedhor përfiton. Testi që zbatohet në një rast të tillë nuk është komponenti sasior, por fakti se financimi i subjekteve politike në garën elektorale është për të arritur qëllime të rëndësishme shoqërore.

ii) *Partitë politike, dhe në fushatë zgjedhore subjektet zgjedhore, kryejnë një funksion publik.* Partitë politike në një mënyrë ose në një tjetër afektojnë jetën e përditshme të individëve dhe janë në vijimësi të angazhuara në procese publike. Për pasojë, është e rëndësishme që ato të jenë të përgjegjshme dhe transparente përpara publikut.

Kodi Zgjedhor në nenin 91 e vijues të tij përcakton procedurën e auditimit të fondeve dhe shpenzimeve të bera gjatë fushatës zgjedhore. Një gjë e tillë nuk ka lidhje me kërkesën e paraqitur dhe detyrimin e subjekteve zgjedhore për t'u përgjigjur. Kodi Zgjedhor përcakton raportin e auditimit mes institucionit shtetëror dmth KQZ-së dhe subjektit zgjedhor që merr pjesë në zgjedhje. Ndërkohë, marrëdhënia jonë me subjektet zgjedhore është vetëm në bazë dhe në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky ligj nuk parashikon dhe nuk ka sesi të parashikojë plotësimin e kërkesës për informacion, nëpërmjet një aktori të tretë, qoftë ky edhe institucioni më i lartë zgjedhor.

Konkluzion

Mbështetur në faktet dhe analizën e mësipërme kërkojmë prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:

- Shfuqizimi i vendimit nr. 44, datë 22.07.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Detyrimin e partive politike (subjekteve zgjedhore) Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim t'i japë Institutit Shqiptar të Shkencave informacionin e kërkuar për financimin e fushatës zgjedhore, të kërkuar prej këtij të fundit në datën 09.06.2014.

PADITËSI
Instituti Shqiptar i Shkencave
Përfaqësuar nga:
Aranita BRAHAJ
Drejtoresh Ekzekutive

Aranita Brahaj
Brahaj

**INSTITUTI SHQIPTAR
I SHKENCAVE
TIRANE - SHQIPËRI**